



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.07.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Vazhdimi i shqyrtimit nen për nen të projektvendimit “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004 “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Alket Hyseni, Edmond Leka, Elena Xhina, Andi Permeti, Aurora Mara, Ediola Braho, Adriatik Alimadhi dhe Edlira Bode.

Mungojnë:

Fatmir Xhafaj, Adnor Shameti, Damian Gjikhuri, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Alban Zeneli, Elda Hoti dhe Tom Doshi.

Të ftuar:

Ervin Bushati

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme. Shumica e anëtarëve janë të pranishëm për të vazhduar me çështjen e vetme që kemi në rendin e ditës: vazhdimin e shqyrtimit nen për nen të projektvendimit “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004 “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”. Për këtë çështje komisioni ynë është komision përgjegjës dhe relatore është kolegja Vasilika Hysi.

Dje e kemi lënë te neni 27 për të vazhduar shqyrtimin e këtij projektvendimi.

Zonja Hysi, vazhdojmë me nenin 27, që ndryshon nenin 40. Do të vazhdojmë me të njëjtën terminologji pune, pra aty ku është i pambyllur neni përkatës i Rregullores do ta lëmë të hapur dhe në votimin në tërësi do t’i marrim në shqyrtim.

Nga stafi i Kuvendit janë prezent nga Shërbimi i Seancës Plenare zonja Pano dhe zonja Shllaku.

Vasilika Hysi – Neni 27 ka të bëjë me veprimtarinë parlamentare. Ky nen sugjerohet të ndryshojë lidhur me pikën 1, konkretisht është sugjerim i kolegut Hyseni, që të quhet veprimtari parlamentare edhe veprimtaria në zonat zgjedhore me argumentin që Kuvendi do ta ushtrojë veprimtarinë e tij për 3 javë, ndërsa 1 javë deputeti do të jetë në zonën e tij.

Unë sugjeroj që pika 2, e cila ka qenë propozim i mëparshëm i kolegëve të opozitës të mos pranohet, pasi bojkoti nuk mund të rregullohet në Rregullore. Për rrjedhojë, neni 40 që flet për “veprimtarinë parlamentare” do të ketë vetëm paragrafin e parë dhe të tretë dhe në paragrafin e parë do të shtohet fjala “ose veprimtari në zonat zgjedhore”.

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin 27? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Po, zoti Alimadhi.

Adriatik Alimadhi – Zoti kryetar, ne jemi te neni 27...

(Diskutime pa mikrofon)

Vasilika Hysi – Ato janë më vete dhe ne ende nuk kemi arritur aty.

(Diskutime pa mikrofon)

Ulsi Manja – Miratohet neni 27.

Kalojmë te neni 28.

Vasilika Hysi – Te neni 28 sugjerohet të shtohen dy nene, neni 40/1 dhe neni 40/2. Ky është një propozim i grupeve parlamentare, praktikë e jetës parlamentare dhe njëkohësisht është përshtatur me Kodin e Sjelljes.

Cili është thelbi i këtij neni, të nderuar kolegë? Kërkohej një riorganizim i veprimtarisë parlamentare. Grupeve parlamentare u jepet mundësia që ditën e hënë ta kenë në dispozicion të veprimtarisë së tyre, për përgatitjen e mbledhjeve të komisioneve, dita e martë dhe e mërkurë të jetë veprimtari në komisione, dita e enjte si rregull është seancë plenare, ndërsa dita e premte është veprimtari e deputetëve dhe e grupeve në zonat e tyre.

Gjithashtu, duke pasur parasysh që ne si deputetë jemi jo vetëm për të bërë ligje, por edhe përfaqësues të zgjedhësve, është parashikuar që një javë të jetë në dispozicion të deputetëve dhe të grupeve parlamentare për veprimtari që do të zhvillohen në zonë, ndërsa ditën e hënë, menjëherë pas javës së katërt, parashikohet të ketë një seancë plenare pasdite nga ora 18:00 deri në orën 22:00. Në këtë seancë do të diskutohen çështje që janë vënë në pah nga ana e zgjedhësve dhe kjo kohë ndahet ndërmjet shumicës dhe pakicës dhe në këtë mënyrë ne përmbushim një nga misionet që ne kemi, të cilën nuk e kemi bërë sa dhe si duhet në Kuvend, për të adresuar të gjitha shqetësimet që kanë zgjedhësit nga zonat që vijmë. Kjo është për nenin 40/1.

Neni 40/2 ka të bëjë me organizimet vullnetare në Kuvend, siç është grupi Aleanca e Grave Deputete, grupi i deputetëve “Miqte e fëmijëve” ose grupi i deputetëve të rinj, që pritet të krijohet ose çdo lloj grupimi tjetër që mund të krijojnë deputetët që është shumëpartiak, pra nuk është njëngjyrësh, nuk është grup parlamentar, por krijohet mbi baza vullnetare, të cilat deri tani kanë funksionuar, por nuk janë njohur në Rregullore, si dhe në bazë të Rregullores nuk kanë qenë të mbështetura nga stafi apo përdorimi i asaj që ne i themi logo. Nëse ju jeni dakord me nenin 40/1 për programimin e veprimtarive parlamentare...

Bashkim Fino – Unë jam plotësisht dakord, por sa i takon javës së katërt, që lihet në dispozicion, në qoftë se ka ndonjë rast emergjent që duhet të bëhet seancë plenare, si rregull duhet të bëhet seancë plenare, sepse nuk është e thënë të jemi *non stop* në zonë. Unë mendoj se nëse ka ndonjë gjë emergjente duhet të mblidhemi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Fino!

Në fakt, për javën e katërt, në pikën 3 thuhet: “Java e katërt kalendarike është në dispozicion të deputetëve dhe të grupeve parlamentare për veprimtaritë e përcaktuar në pikën 1”, themi ne, ndërsa në pikën 5 thuhet: “Rregullat e parashikuara në pikat 1 dhe 5 të këtij neni nuk

zbatohen kur Kuvendi ka një çështje urgjente apo kërkesë për një projektakt me procedurë të përsheptuar për shqyrtimin dhe miratimin e tij”.

Pra, në javën e katërt jo vetëm që mund të bëhet seancë, por mund të ketë edhe mbledhje komisionesh, kur ka gjëra të tilla.

Ulsi Manja – Kam një pyetje zonja Hysi. Në germën “b” të pikës 1 thuhet: “Ditën e martë dhe të mërkurë si rregull janë veprimtaritë në komisionet e përhershme...

(Diskutime pa mikrofon)

Si rregull është lënë në funksion të grupeve parlamentare, por kam përshtypjen se këtu për ditën e mërkurë flitet për veprimtaritë e komisioneve në javën pasardhëse, sepse duhet të kemi parasysh 48-orëshin e depozitimit të raportit për seancën?

(Diskutime pa mikrofon)

Pra, flitet gjithmonë për javën pasardhëse.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar,

Të nderuar kolegë,

Në nenet në vijim dhe në nenet që kemi kaluar veprimtaria parlamentare ka një shtrirje kohore, kështu që u jepet kohë komisioneve për të pasur kohë të mjaftueshme, por nuk duhet të harroni që ka edhe një nen, të cilin do ta diskutojmë më vonë, që relatorëve do t’u lihen në dispozicion 4 ditë për hartimin e raportit që nga momenti i mbylljes së shqyrtimit të çështjes në komision.

Ulsi Manja – Dakord.

Po, zoti Alimadhi.

Adriatik Alimadhi – Unë e kam për pikën 4 në të cilën thuhet: “Në kohën prej 2 orësh të diskutimit për shumicën apo pakicën 90 minuta i përkasin grupit parlamentar me numrin më të lartë të deputetëve dhe 30 minuta të tjerëve”. Unë mendoj se kjo...

(Diskutime pa mikrofon)

Ne patëm një rast tani, ishim 23 deputetë dhe ne kishim në dispozicion një kohë prej 20 minutash për të folur, pra i bie që ne nuk kishim as një minutë në dispozicion për të folur...

(Diskutime pa mikrofon)

Ulsi Manja – 60 minutëshin e diskutimit jashtë rendit të ditës asnjë nga deputetët nuk e ka përdorur këtë kohë. Kjo është e rëndësishme...

Adriatik Alimadhi – Sa i takon rendit të ditës..

(Diskutime pa mikrofon)

Ne kishim një seancë debat për dekretin e Presidentit...

(Diskutime pa mikrofon)

Nuk është kjo për rendin e ditës?

(Diskutime pa mikrofon)

Vasilika Hysi – Duke u bazuar në shqetësimin që ngre zoti Alimadhi, por e kuptoj që këtë shqetësim e ka edhe zonja Xhina, ne mund të bëjmë një riformulim për 30-minutëshin ku të themi: “Në kohën prej 2 orësh diskutimi për shumicën ose pakicën, 90 minuta i përkasin grupit parlamentar me numrin më të lartë të deputetëve dhe 30 minutat e tjera për grupet e tjera parlamentare të pakicës ose deputetëve të pavarur. Është shumë e drejtë ajo që thotë kryetari i komisionit që ne kemi 60 minuta në dispozicion, por nuk janë përdorur. Në rastin konkret jo të gjithë deputetët çdo javë, çdo ditë të hënë të javës që pason veprimtarinë njohëse mund të kenë problem në zonat e tyre, por flasim për ata deputetë të cilët kanë një shqetësim dhe duan që ministri t’i dëgjojë dhe të adresojë problemin. Mjafton problemi, sepse për diskutime të tilla ne kemi edhe 5 minutëshin, përsëri në çdo seancë plenare. Mos harroni se kemi shtuar një nen tjetër që në çdo seancë plenare kemi 45 minuta pyetje dhe përgjigje me kryeministrin dhe me ministrat. Ju lutem, shikojini edhe nenet që janë në vazhdimësi!

Alket Hyseni – Për të bërë disa formulime që i qëndrojnë kohës, jemi dakord për kohën e pasdites, sepse deputetët vijnë nga zonat e tyre dhe ka sens që bëhet paradite, por mos të themi dy orë njëra dhe dy orë tjetra, por “koha ndahet në mënyrë të barabartë mes shumicës dhe pakicës”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne do t’i japim opozitës gjysmën e kohës, të njëjtën kohë që ka shumica. Pra, duhet të themi “Koha mes maxhorancës dhe opozitës është e barabartë”. Vazhdimi i fjalisë është në rregull.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vasilika Hysi- Sugjerimi që bën zonja Xhina, që koha është e barabartë, duhet shkruar. Nuk mund të përdoren të 4 orët, por nuk do të ketë seancë tej orës 22:00. Ne po shkojmë drejt rregullave, që edhe diskutimet do të jenë si në Parlamentin European dhe në Këshillin e Europës me minutazh të shkurtër në diskutimet për projektligjet. Në këtë kuadër, kur thuhet interval 18-22, mund të jetë 18-19, 18-20. Koha do të jetë 2 orë shumica parlamentare maksimumi dy orë pakica. Rregullorja kërkon që të rregullohet brenda grupeve të pakicës?

Andi Përmeti - Ne me kohën jemi dakord, si ndasi, edhe me zotin Hyseni jemi dakord, problemi është se ju gjithmonë pa të keq jeni marrë me PD-në, e ka bërë Alibeaj, e ka bërë ky, e ka bërë ai, mbeten dy grupe të mëdha parlamentare. A mund ta shtoni fjalën “edhe deputetët e pavarur”?

(Diskutim pa mikrofon)

Ulsi Manja- Po, zoti Hyseni.

Alket Hyseni- Biem dakord të gjithë. Do të ruajmë intervalin kohor 18-20. Formulimi do të jetë: “Koha e diskutimeve ndahet në mënyrë të barabartë mes shumicës dhe pakicës”.

Sa i përket kohës së diskutimeve, jo më shumë se 90 minuta i përkasin grupit parlamentar me numrin më të madh dhe jo më shumë se 30. Pra, duke mbajtur një tavan, të mos themi 90 minuta, sepse pastaj do të detyrohemi me Rregullore që çdo seancë duhet të jetë 4 orë, ndërkohë nuk është e nevojshme.

Ulsi Manja- Faleminderit, zoti Hyseni!

Fjalën e ka zoti Fino.

Bashkim Fino- Meqenëse ky është propozimi i Alibeajt, i Partisë Demokratike, për të qenë korrekt unë them se mund ta lëmë kështu. Ne duhet të heqim kohën 18-22, se nuk kemi pse vëmë në Rregullore kohën që duhet të jetë 4 orë e lëmë të hapur dhe themi: “Koha e diskutimeve, si rregull, 2 orë për shumicën parlamentare dhe 2 orë për opozitën”. Mund të kërkojë 1.30 minuta shumica parlamentare, mund të kërkojë gjysmë ore opozita, jo më shumë, prandaj është fjala “ si rregull”, rregullon tavanin. Gjithë pjesa mbrapa është kot, e ndajnë vetë ata. Së pari, nuk vendosim orën 18-22, se mund të vejë edhe 18-21.

Ulsi Manja – Pra, propozimi i Finos për të hequr orën, por thjesht kohën është më i saktë.

Bashkim Fino- Si rregull 2 orë maxhoranca dhe si rregull 2 orë opozita. Kaq mbyllet këtu. Pastaj si ndahet brenda tyre pak rëndësi ka.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja- Zoti Alimadhi.

Adriatik Alimadhi- Aktualisht ndodhi në seancën për materialin që Komisioni i Ligjeve ia nisi seancës plenare.

Pati diskutime nga deputetët e pavarur për kohën e minutazhit. Pra, koha që ne kishim në dispozicion, sipas Rregullores, ishte 20 minuta, por kishim 23 deputetë, të cilët donin të flisnin të gjithë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne po themi të krijohet mundësia.

Së dyti, zonja Hysi, nga kush ka qenë propozimi që është vendosur 18-22?

Vasilika Hysi - Zoti Alimadhi, faleminderit për pyetjen!

Dita e hënë është ditë për veprimtari të grupeve parlamentare, mbledhje grupesh, mund të ketë punë në komisione.

Së dyti, shumë deputetë vijnë nga zonat e tyre, sepse kanë qenë në zonë një javë më parë, për rrjedhojë duke pasur aktivitet paradite dhe seancë pasdite, mirë është që të përcaktohet ora 18:00. Unë bie dakord me sugjerimin e zotit Fino, zotit Hyseni dhe zonjës Xhina që propozojnë që, si rregull të jetë jo më shumë se dy orë për njërin, por gjithmonë 2 orë, jo më shumë se dy orë, sepse pastaj do të kemi seanca maratonë.

Të nderuar kolegë, ka disa nene që ne do t'i shqyrtojmë në vijimësi, ku ka rregulla për 5 minutëshin, 30 minuta për kryeministrin në çdo seancë plenare, ndërsa për çdo ministër do të ketë 7 pyetje në çdo seancë. Po të kemi shumë pyetje dhe çështje për të adresuar, do të na dalë koha mjaftueshëm, problemi është sa ne do t'i përgjigjemi zgjedhësve, sa do të mundemi ne të marrim problematikat e tyre dhe t'i adresojmë. Kjo është. Po të shikoni, ka shumë nene, ka një rregullim shumë të mirë falë angazhimit që keni pasur.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja- Zonja Hysi, a ka mundësi ta hedhin në votim, se jemi të gjithë dakord që do të jenë 4 orë debat, gjysmë për gjysmë, si rregull, gjysmë për shumicën dhe gjysmë për pakicën dhe brenda grupeve respektive do të ketë ndarje respektive të kohës. Jemi të gjithë dakord, por është çështja e riformulimit. Tani ta hedhim në votim! Formulimin e saktë ta bëjë relatorja me zonjën Pano, duke shtuar “ edhe deputetët e pavarur”!

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenime?

Miratohet neni 28 duke shtuar edhe nenin 40/1 dhe nenin 40/2.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vasilika Hysi – Te neni 42/2, te paragrafi i katërt shkruhet: “Brenda 30 ditëve nga konstituimi i grupit”, sepse grupi mund të konstatohet edhe në mes të sesionit plenar.

Ulsi Manja- Kalojmë te neni 29, që ndryshon nenin 41.

Vasilika Hysi– Neni 29 është një propozim i të gjithë deputetëve lidhur me aktivizimin e specialistëve të jashtëm.

Të nderuar kolegë, Kuvendi do të ketë shumë aktivitete në kuadër të hapjes së negociatave, por për shumë ligje ne kemi nevojë për ekspertizë të jashtme. Nuk ka qenë e rregulluar, siç duhet në nenin 21 të Rregullores, dhe ne kemi bërë një riformulim ku japim mundësi komisionit ose këshillave të aktivizojnë specialistët dhe ekspertë për realizimin e detyrave të tyre, kur Kuvendi nuk zotëron ekspertizën e nevojshme për një çështje të caktuar, pra jo për çdo lloj çështjeje.

E dyta, bazuar në problematikat që kanë lindur në praktikë për pagesat, për mënyrën si merren ekspertët, kemi autorizuar Byronë e Kuvendit, që mbi bazën e propozimit të komisionit dhe të këshillit përkatës, të bëjë me vendim aktivizimin e specialistëve dhe të ekspertëve të jashtëm.

Ulsi Manja – Normal që Byroja, sepse ajo menaxhon anën financiare.

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Zonja Hysi, faleminderit!

Unë kam vetëm një pyetje: çfarë ka ndodhur nga eksperiencia që e vëmë këtë nen? Pse na duhen shumë ekspertë e këshilltarë kur kemi një strukturë prej 405 vetash duke futur edhe 140 deputetët? Nuk është se jam gjirokastrit dhe dua të kursej fondet e Kuvendit, por meqenëse ne i kemi ekspertët dhe struktura miratohet nga sekretari i Përgjithshëm dhe Kryetari i Kuvendit, duhet të kemi nga të gjithë llojet e ekspertëve. Në qoftë se në eksperiencën e deritanishme ka ndodhur që kemi kërkuar ekspertë të jashtëm, që nuk i kemi paguar dot, se ky është thelbi i kësaj, ejani ta vëmë, por në qoftë se këta ekspertë që kemi kërkuar mund t'i adoptojmë në strukturën që bën Kuvendi, nuk kemi pse ta vëmë një gjë të tillë.

Më falni, që po ju ndërhyj, por hapet loja më shumë seç duhet pastaj!

Ulsi Manja – Mendoj se neni 41 i Rregullores, që bën fjalë për aktivizimin e specialistëve të jashtëm, thjesht është riformuluar ndryshe, se po ky nen mbetet.

Pra, unë shoh riformulim këtu, se deri tani nuk na ka penguar askush të marrim ekspertë të jashtëm, dhe e kemi bërë këtë. Byroja e Kuvendit ka miratuar pagesën e ekspertëve dhe me kërkesë të komisionit ose të këshillit janë marrë ekspertë të jashtëm.

Unë shoh që neni 41 thjesht është riformuluar, por në thelb ka mbetur i njëjtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Duhet ta vendosë komisioni, zoti Fino, me vendim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Duhet ta hedhë në votim komisioni.

Vasilika Hysi - Faleminderit, zoti Fino!

Ky nen ekziston në Rregullore, por është shumë i përgjithshëm dhe pikërisht mënyra se si është formuluar shkon me atë që thotë zoti Fino, që kushdo mund të marrë specialistë.

Në fakt, ne kërkojmë ekspertë për rastet kur Kuvendi kërkon ekspertizë në një fushë të caktuar.

Hapja e negociatave, janë 35 kapituj. Sado ekspertë, këshilltarë ligjorë e ekonomikë të kemi në Kuvend, ne nuk jemi profesionistë në të gjitha fushat. Gjithashtu, lidhur me atë që thotë zoti Fino, ne kemi pasur një ligj për falimentin, ku Kuvendi i Shqipërisë nuk kishte ekspertizë. Unë kam qenë relatore, por nuk jam eksperte në këtë fushë. Ligji ishte përgatitur nga Banka Botërore dhe ishim në një situatë bashkë me Komisionin e Ekonomisë që nuk kishte ekspertizë, sepse ishte një ligj i ri me 300 nene. Në këtë kuadër na lindi nevoja për të marrë ekspertizë, morëm ekspertizë jo në bazë të ligjit, se nuk na i lejonte sa duhet Rregullorja, por në formë miqësore, e thënë troç.

Si mund ta shmangim lobizmin dhe konfliktin e interesit? Si mund t'u sigurojmë deputetëve dhe relatorëve, siç ishte rasti i Këshillit të Legjislacionit, Kodit Zgjedhor? Në këtë kuadër ne rregullojmë, zoti Fino, vetëm çështjet kur Kuvendi nuk ka ekspertizë. Pra, propozimi shkon me atë që thoni ju.

Bashkim Fino – Domethënë, ne më parë e kishim të hapur këtë gjë, mund ta kërkonte çdo deputet, dhe ndërkohë me riformulimin që keni bërë e ngushtoni dhe thoni: "...kur komisionet e kërkojnë një gjë të tillë".

Më para...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pra, po pse e kufizon tani?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, unë jam të mos ketë fare, por meqenëse ti do ta vësh, mos kufizo atë që është, se është shumë mirë në Rregullore siç është.

Unë jam të mos vihet fare.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Finno!

Fjala për zotin Alimadhi.

Adriatik Alimadhi - Pika e dytë "Aktivizimi i specialistëve dhe ekspertëve të jashtëm bëhet me vendim të Byrosë së Kuvendit mbi bazën e propozimit të komisionit ose të këshillit përkatës".

A mos është më mirë ta lëmë të prerë “komisioni” dhe jo “ose këshillit përkatës”, sepse edhe komisionit, edhe këshillit përkatës, duket sikur e sorollatim ekspertin.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Alimadhi!

Vasilika Hysi – Zoti Alimadhi, në shumicën e rasteve ne i kemi marrë ekspertët në Këshillin e Legjislacionit, në Komisionin e Reformës Zgjedhore apo në Këshillin e Mandateve kur kemi pasur probleme për çështje të caktuara e të tjerë.

Në përgjithësi komisionet nuk kanë marrë ekspertë, vetëm Komisioni i Reformës në Drejtësi ka pasur ekspertë. Problemi qëndron, duke vazhduar sërish në shqetësimin që ngre zoti Fino, komisioni do të marrë një vendim për të pasur ekspertizë, se do të bëhet një shkresë, ka një procedurë që Byroja do të vihet në lëvizje. Në këtë kuadër, në qoftë se kemi ekspertizë në parlament, nuk ke pse të marrësh të tjerë, por në rastet kur nuk kemi, pa dyshim që do të marrim ekspertë të fushave të caktuara, si: në peshkim, energjetikë, pasi ne nuk jemi ekspertë për gjithçka.

Kam një propozim, zoti kryetar, ta hedhim në votim siç është në Rregullore dhe siç propozohet. Ky propozim nuk është imi, si relatore, por i grupit të punës. Kemi qenë 10 deputetë që kemi punuar rreth kësaj.

Ulsi Manja – A ka propozim konkret që ta hedhim në votim? Kur nuk ka propozim alternativ, të ecim.

Zoti Hyseni.

Alket Hyseni – Kam dy-tri momente korigjimesh të vogla, të cilat do përmirësojnë nenin. Unë jam pro këtij ndryshimi, ai është domosdoshmëri, e ka edhe ligji nr. 9000 për Këshillin e Ministrave nevojën për ekspertizë të jashtme, sepse është e pamundur të rekrutosh të gjithë ekspertizën. Mund të kesh ekonomistë, juristë, por jo të të gjitha fushave. Ajo që dua është që të jemi në unison edhe me Kodin e Procedurës, edhe me ligjin nr. 9000, si formulim jo aktivizimi i ekspertëve, por caktimi.

E dyta, ekspert i jashtëm i përkohshëm, sepse mund të lëmë vend për abuzime me rekrutime të përhershme, të hiqet “mbi bazën e propozimeve” dhe të lihet “mbi propozimin e komisionit ose këshillit”.

Pra, nga pikëpamja e teknikës, i rregullon...

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin 29 me propozimet e kolegut Hyseni? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 30.

Vasilika Hysi – Neni 30 bën një ndryshim në nenin 44, që ka të bëjë me fillimin e seancës plenare dhe ndryshon pikërisht vetëm pika 3. Është saktësuar se çfarë njofton drejtuesi i seancës që në fillim, pra pjesa me *bold* është shtuar “Dekretet e Presidentit, projektaktet e natyrave të ndryshme, propozimet për zgjedhje, emërim shkarkim, pyetje të kërkuara, interpelancat, kërkimet, promocion...”, dhe këtu, zoti kryetar, bazuar në propozimin që bëtë dje “shkarkim të titullarëve dhe të anëtarëve të bordeve” janë të gjithë bashkë, që e keni merak.

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin 30?

(Diskutim pa mikrofon)

Alket Hyseni – E di çfarë ndodh, ta shpjegojmë zoti Fino: mund të jenë 10 ligje apo 20, dhe që të mos rrijë Kryetari i Kuvendit e të lexojë ato...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E ka e gjithë bota kështu. Parlamenti Britanik, ka sekretarin e procedurave që i lexon, jo kryetari.

Ulsi Manja – Ju lutem, e hedhim në votim. Kush është dakord me nenin 30. Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 31.

Vasilika Hysi – Dua t’ju bëj një njoftim, të nderuar kolegë: nëse kur t’u rikthehemi neneve të hapura, sekretariati për procedurën dhe për votimin do të jetë shkalla e parë e dhënies së masave disiplinore, atëherë në këtë nen do të shtojmë edhe fjalën “i etikës”.

Ulsi Manja – Vazhdojmë me nenin 31.

Vasilika Hysi – Neni 31 amendon pikën 1 të nenit 48, që ka të bëjë me kohën e diskutimeve. Që sot me miratimin e kësaj Rregulloreje në seancë plenare, diskutimet nuk do të jenë më të gjata se 10 minuta, pavarësisht nëse është ligj, marrëveshje, ligj me shumicë të cilësuar e të tjerë. Pra, diskutimet do të jenë jo më shumë se 10 minuta dhe risia është që drejtuesi i seancës mund të ndërpresë fjalën e diskutantit, kur diskutimi është jashtë thelbit të çështjes. Pra, nëse në seancë jemi duke diskutuar për energjinë dhe diskutanti flet për shëndetësinë apo diçka tjetër.

Ulsi Manja – Pra, ka një ndryshim të vogël në neni 48.

Kush është dakord me neni 31?

Adriatik Alimadhi - Ju lutem, zoti kryetar!

Ulsi Manja – Urdhëroni, zoti Alimadhi!

Adriatik Alimadhi – Unë nuk e mendoj kështu, sepse duke parë veprimtarinë e deputetit në tërësi, ai është i pavarur dhe ne nuk mund t'ia ndërpresim të gjitha të drejtat për të folur.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sido që të jetë.

(Diskutime pa mikrofon)

Ulsi Manja – Keni 45 minuta, 60 minuta, 2 orë kohë në dispozicion.

(Diskutime pa mikrofon)

Më falni, të sqarohemi për këtë pjesë.

Alket Hyseni – Zoti Alimadhi, deputeti i ka të gjitha të drejtat procedurale për të ushtruar përfaqësimin. Në rastin konkret flitet për diskutimet e një rendi të caktuar dite, për një ligj ose një marrëveshje të caktuar. Çfarë ndodh? Deputeti ngrihet dhe nuk flet për ligjin. Ndërkohë, për problemet e zonës, për çështje politike, deputeti ka në dispozicion një minutash të caktuar, ka pyetje, ka interpelanca. Pra, i ka të gjithë mekanizmat për të ushtruar plotësisht të drejtën e përfaqësimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem, zoti Alimadhi, ndizni mikrofonin!

Adriatik Alimadhi – ...kur deputetët e opozitës dalin në podium dhe u ndërpritet fjala, e quajnë zotin Ruçi “diktator”. Çfarë do të thotë kjo? Në momentin kur një deputet flet, unë e shikoj si problem nëse ju ndërhyini dhe thoni: “ta ndërpresë Kryetari i Kuvendit ose drejtuesi i seancës”, sepse sa minuta ka në dispozicion një deputet për të folur? Ka 10 minuta në dispozicion. Një deputet mund të ketë një ...

(Diskutime pa mikrofon)

Dakord.

Nga eksperiencia ime prej 3 muajsh, ka pasur raste kur një deputet ka dalë në podium dhe ka ngritur një shqetësim. “Një minutë heshtje”, - thotë deputeti...

(Diskutime pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem!

Zoti Fino! Zoti Hyseni!

(Diskutime pa mikrofon)

Adriatik Alimadhi – Mos na krahasoni menjëherë me Parlamentin Europian.

Bashkim Fino – Ky është neni më i rëndësishëm që po rregullojmë. E dini pse? Nga eksperiencia ime, ka pasur dy lloje diskutimesh: 10 dhe 20 minuta për marrëveshjet. Për shembull, KfW-ja gjermane jep 3 milionë euro për një investim, që, përgjithësisht, edhe kur ne kemi qenë në opozitë, këto marrëveshje votoheshin me të gjitha votat e deputetëve, sepse janë grante të ndryshme. Deputetët kishin 20 minuta në dispozicion për të folur për marrëveshjen dhe 10 minuta për një ligj shumë më të rëndësishëm. Ndonjëherë abuzohet me kohën 20 minuta, sepse nisin të flasin për marrëveshjen dhe vazhdojnë me politikën e ditës. Ne duhet të rregullojmë dhe detajojmë Rregulloren, të hënën të bëhet seancë pyetjesh me të gjithë ministrat, sipas zonave, dhe çdo deputet të mund të flasë për problematikat e zonës së vetë, të martën dhe të mërkurën të zhvillohen komisione dhe të enjten të bëhet seancë plenare. Në seancë plenare të flitet për ligje të veçanta.

Ne, deputetët, bëjmë politikë, është e vërtetë, por politika duhet bërë në funksion të ligjit që është në diskutim. Ti dhe unë bashkë nuk mund të bëjmë politikë për politikën e ditës. Pra, nëse unë kam një ligj për energjinë, duhet të flasë për të, të bëjë edhe politikë, nëse qeveria e ka të gabuar politikën e vetë dhe ligjin që ka sjellë, ta bëjë copë në parlament, por në mundësinë e 10 minutave që kam në dispozicion dhe kaq. Realisht duhet të ketë një disiplinë të tillë. Në të gjitha parlamentet europiane ka minutazh të shkurtër dhe diskutimi bëhet brenda rendit të ditës. Në periudhën e fundit, por edhe më parë, kjo ka devijuar, sepse merret fjala për energjinë dhe flitet për politikën e ditës.

Ky nen i rregullores është shumë i rëndësishëm, zoti kryetar. Minutazhi 10 minuta është shumë mirë, që, të gjithë të flasim sipas rregullave.

Ulsi Manja – Hedhim në votim nenin 31, sepse mendoj se është i rregulluar shumë mirë.

Kush është pro? Kundër?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Alimadhi, është i rregulluar, sepse deputeti ka kohë për të folur.

Adriatik Alimadhi – Kjo ka interes për opinionin publik, por deputetit, nëse ju kërkoni t'ia hiqni të gjitha të drejtat...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ulsi Manja – Ta mbarojë idenë.

Adriatik Alimadhi – Çfarë mund të shprehë deputeti brenda kohës 10 minuta?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kjo më duket detyruese.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Adriatik Alimadhi - Jam shumë i qartë. Kur kaluam projektligjin “Për shërbimin përmbartimor privat” në seancë plenare, iu drejtova edhe deputetëve socialistë, sepse isha shumë kureshtar të dëgjoja mendimet e të gjithë deputetëve për projektligjin. Rendi i ditës ishte për projektligjin e shërbimit përmbartimor, por asnjë nga deputetët nuk po fliste për të.

Ulsi Manja – Zoti Alimadhi, mund ta përmbyllni, ju lutem?

Adriatik Alimadhi – Nëse ju do të vendosni me votë, e shikoj ...

(Diskutime pa mikrofon)

Më duket sikur po bëhem shkaktar për ...

(Diskutime pa mikrofon)

Krijoni një ide ndryshe, një mendim të lirë ...

(Diskutime pa mikrofon)

Ç’lidhje ka?

(Diskutime pa mikrofon)

Lejojeni deputetin të shprehet lirshëm.

(Diskutime pa mikrofon)

Jo, e detyrojmë, e fusim në një linjë...

(Diskutime pa mikrofon)

Këtu dalim te koncepti i lirë.

(Diskutime pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem!

Unë isha në procedurë votimi.

Zoti Alimadhi ka atë qëndrim, ne kemi këtë qëndrim. Të mos ngelemi te neni 31.

Kush është pro nenit 31? Kundër? 1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Vasilika Hysi – Kryetar, mos harroni që shfuqizohet edhe pika 2, “20 minutëshi”.

Ulsi Manja – Ju lutem, zonja Hysi!

Vazhdojmë me nenin 32.

Ju lutem, nuk mund të ecim kështu, sepse unë në orën 12:00 kam mbledhje tjetër.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, ju takon juve ta hidhni në votim.

(Diskutime pa mikrofon)

Ulsi Manja – Të nderuar kolegë deputetë, zonja Hysi, si relatores, nuk do të lexojë përmbajtjen e neneve, sepse i keni në tavolinë.

(Diskutime pa mikrofon)

Ju lutem, zoti Fino!

Kush ka propozime konkrete, të marrë fjalën. Nëse nuk keni propozime konkrete, do të operojmë me votimin.

Zonja Hysi, mos e lexoni përmbajtjen e të gjithë dispozitës!

Vasilika Hysi – Neni 55.

Ulsi Manja – Neni 32, që rregullon nenin 55 “Kuorumi dhe vendimmarrja në seancë plenare”, është reflektim i vendimit të vitit 2009-2011 të Gjykatës Kushtetuese, propozim i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste për të reflektuar këto dy vendime, kur rregullohet qartësisht, kur quhet kuorumi për çeljen e seancës së votimit parlamentar.

Ulsi Manja – Ka sugjerime për këtë nen?

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Kam vënë re, edhe më parë, edhe tani, që në përfundim të diskutimeve në Kuvend, Kryetari i Kuvendit thotë: “Hapim votimin për prezencën”. Pse duhet të hapim votim për prezencë në orën 17:00, kur seanca ka filluar në orën 10:00?

(Diskutime pa mikrofon)

Për mua, në këtë nen, që ti ke bërë shumë mirë, kuorumi fillon në orën 10:00. Kryetari apo nënkryetari i Kuvendit, kur fillon seanca plenare, thotë “Hapim votimin për prezencën” dhe “janë 71 deputetë”. Fillon diskutimi dhe kur mbarojnë të gjitha diskutimet në orën 17:00, hapet diskutimi për ligjet. Dikush mund të ketë ardhur me vonesë, nuk ka asnjë problem; mund të ketë ikur ndonjë që ka qenë në orën 10:00 për një mijë e një arsye. Çfarë do të bëjmë ne? Duhet të disiplinojmë veten, pavarësisht se Kuvendi është disiplinuar. Ne nuk vijmë në orën 10:00, sepse e dimë që do të votohet në orën 17:00 dhe atëherë vijmë të gjithë për të votuar. Si në komision për shembull, kryetari i komisionit numëron nëse janë apo jo 11 veta dhe më pas thotë që kuorumi është plotësuar. Po të mos plotësohet kuorumi, nuk fillon mbledhja, edhe ai atje nuk do të fillojë. Për mua të vendoset në Rregullore që kuorumi të bëhet në orën 10:00 kur fillon seanca plenare, pastaj, kur fillojë votimi i ligjeve, të votohet me aq deputetë sa janë atje, sepse presupozohet se është kuorumi. Më fal për ndërhyrjen, por më duhet ta saktësoj.

Ulsi Manja – Po, Moza.

Mimoza Pano – Sugjerimin që thotë zoti Fino Rregullorja e ka pasur para vitit 2004. Nga eksperiencia e atëhershme ka pasur vështirësi për fillimin e seancës në orën 10:00, për shkak se deputetët nuk mblidheshin dhe mund t’ju them se ka pasur raste kur është anuluar zhvillimi i seancës plenare, sepse kuorumi me 71 deputetë nuk është bërë edhe pas shtyrjes për një apo dy orë të seancës. Prandaj për rregulloren e vitit 2004, në mirëkuptim me të gjitha grupet parlamentare, është dakordësuar që të hiqet kuorumi i orës 10:00 dhe verifikimi të bëhet vetëm në fillimin e votimit. Kjo është bërë për shkak të pengesës për fillimin e seancës.

Ulsi Manja – Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Moza me këtë na thotë se seanca fillon pa kuorum, pra grupet kanë rënë dakord që mund të shkojë vetëm Kryetari i Kuvendit me 10 deputetë dhe të fillojnë diskutimin. Kjo për mua është shkelje e Rregullores. Nuk mundemi të bëjmë marrëveshje mes grupeve që seanca të fillojë me 10 apo 15 deputetë në orën 10:00, meqenëse nuk na del gjumi dhe kuorumi të bëhet kur të votohet ligji. Është normale që në atë moment do të jetë numri i deputetëve, sepse nuk kalon ligji.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kam edhe një pyetje: zoti kryetar, përse jeni shumë korrekt kur fillon mbledhja e Komisionit të Ligjeve?

Ulsi Manja – Sepse më detyron Rregullorja.

Bashkim Fino – Atëherë duhet t’i detyrojë Rregullorja të gjithë deputetët, edhe Kryetarin e Kuvendit që të jenë 71 veta në sallë dhe pastaj të fillojë seanca.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem, mund t’i marrim me radhë propozimet, që të mos vonohemi?

Fjalën e ka zoti Bushati.

Ervin Bushati – Meqë kam qenë në grupin e punës dhe ka 1 vit e gjysmë që diskutojmë, unë mendoj se në një ditë kur mund të ketë një sërë ligjesh që miratohen, pra mund të ketë 30 ligje për miratim, në ligjin e parë mund të jenë deputetët e komisionit përkatës me 5 veta që do të flasin, sepse ne nuk mund të presim që të paraqiten të gjithë, ndërkohë që procedura edhe në Parlamentin Europian, edhe në Asamblenë e Këshillit të Europës hapet dhe vetëm kur votohet duhet të jetë kuorumi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe në komision votohet çdo ligj në momentin që diskutohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk është procedurë e njëjtë. Meqë bëhet në komision, të bëhet edhe në seancë plenare, ashtu i bie që të mos fillojë seanca.

Ulsi Manja – Fjalën e ka zoti Përmeti.

Andi Përmeti – Zonja Pano, mua më vjen keq që dëgjova atë fjali. Unë jam i ri në Kuvend, por është përgjegjshmëri që ne paguhemi me rroga aq të larta nga taksapaguesit dhe ne të mos kemi guximin të mblidhemi në orën 10:00...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, të mos paraqitemi në ditën e punës...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më fal, të mbaroj unë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë çdo ditë kam qenë në seancë në orën 9:30 dhe ju kam takuar ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e kam për elektorat, e kam për përgjegjshmëri të detyrueshme me ligj, ashtu siç thotë zoti Fino. Seanca të mos fillojë kurrë, nëse deputetët flenë deri në orën 11:00.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kurrë të mos vijë Basha, ai tani është në shtëpi. Po të duash ndiqe edhe ti Bashën, zoti Bushati.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të merren edhe masa nëse është e nevojshme.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Po, zonja Xhina.

Elena Xhina – Nëse i referohemi propozimit që kemi përpara, ku flitet për momentin e hapjen e seancës dhe kërkohet kuorumi, prandaj diskutimi mua më duket ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Seanca e votimit është seancë më vete dhe nuk futet në seancën plenare? Po çuditem me këtë logjikë. Këtu thuhet: “Në momentin e hapjes së seancës plenare duhet të jenë 71 deputetë”, kështu është propozimi, prandaj duhet të diskutojmë për këtë propozim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Seanca plenare dhe seanca e votimit janë e njëjta gjë, sepse nuk fillon seanca plenare më vete dhe ajo e votimit më vete.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këtë po them. Ne duhet të merremi me propozimin konkret, këtu kemi hapjen e seancës...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kërkoj që zonja Hysi ta shpjegojë se për cilin moment bëhet fjalë, për momentin e hapjes së seancës plenare apo për momentin e fillimit të votimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Fjalën e ka zonja Hysi.

(Zonja Hysi flet pa mikrofon)

Vasilika Hysi – Ky nen flet për kuorumin në vendimmarrjen e seancës plenare, ne themi: ka dy vendime të Gjykatës Kushtetuese dhe ky nen është reflektim i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, pra është vendimi i viteve 2009 – 2011. Ka pasur një debat për një votim që ka bërë Kuvendi dhe thuhej: “Nëse ishin 71 deputetë apo nuk ishin”. Ideja është se mund të jesh i pranishëm, por nuk voton dhe nuk ke kuorum, prandaj Kryetari i Kuvendit thotë hiqni kartat. Ne po zgjidhim atë problem që kemi pasur kur kemi qenë në opozitë, por e bën edhe opozita sot, vijnë të diskutojnë, pastaj ikin dhe ne nuk kemi kuorum për të votuar ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, ta mbaroj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Nëse e konsideroni veten se jeni në kafe, flisni pa mikrofonta. Asnjë nuk mund ta ndez mikrofonin, sepse e fik unë. Ne vendosëm një rregull që kush ka propozim konkret, ta bëjë propozimin dhe ta hedhim në votim, një pro dhe një kundër. Unë jam në mbledhjen e Komisionit të Ligjeve, nuk jam në grupin e punës për diskutimin e Rregullores së Kuvendit.

Kjo Rregullore do të kalojë në seancën e datës 18 korrik. Nëse ju doni të ecim me 4 nene në ditë, unë do t’ju thërras përsëri nesër, të shtunën dhe të dielën në Komisionin e Ligjeve për të vazhduar me Rregulloren, sepse do të ketë mbledhje komisioni...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ndërkohë që mbytemi me një pikë ujë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja Hysi thotë: “Është reflektim i Gjykatës Kushtetuese i viteve 2009-2011”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Hyseni, keni një propozim?

Alket Hyseni – Dua të sqaroj kolegët, duke mbështetur fort relatorin. Dua të jeni të vëmendshëm, sepse këtu nuk jemi për të bërë sofizma, por flitet për kuorumin e vendimmarrjes. Këtu ka një lapsus me termin “hapje”, i cili sjell konfuzion, prandaj mund ta bëjmë direkt “Kuorumi për seancën e votimit parlamentar është të paktën 71 deputetë”, sepse është edhe detyrim i Gjykatës Kushtetuese. Pra, të heqim termin “hapje”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Aty synim ka qenë “hapje e votimit”, por duke thënë “hapjen e seancës” sjell pak konfuzion, prandaj ta bëjmë direkt: “kuorumin për hapjen e votimit” ose “kuorumi për seancën e votimit”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sjell konfuzion me fillimin dhe do na sjellë probleme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Elena, kjo është e rregulluar, sepse ka 28 vjet në parlament. Zonja Pano, a ka pasur probleme në këto dy legjislatura e fundit?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, ka pasur dhe është rregulluar nga Gjykata Kushtetuese sezonin e kaluar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zonja Bushka.

Klotilda Bushka – Jemi duke diskutuar kaq shumë kur gjërat janë të qarta. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, që sqaroi relatorja, ka të bëjë me përshtatjen fjalë për fjalë të dispozitivit të vendimit në tekstin që keni përpara.

Dispozitivi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese thotë: “Interpretohet pika 1 e nenit 78 të Kushtetutës si vijon” dhe thuhet: “Numri i deputetëve të pranishëm për hapjen e seancës së votimit parlamentar është minimalisht 71 deputetë”. Këtë e thotë Gjykata Kushtetuese dhe ju nuk dilni dot jashtë kësaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Fino të mbarojë.

Formulimi që ka propozuar grupi u punës dhe që relatorja paraqiti është: “Kuorumi për çeljen e seancës së votimit parlamentar është të paktën 71 deputetë”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është e qartë.

Sipas zotit Hyseni është propozuar që për çeljen e seancës të jenë të paktën 71 deputetë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këtë do t'ju them, por nëse e lëmë njëri-tjetrin të flasë. Jam dakord të hiqet fjala “seanca” dhe formulimi siç është bërë është në rregull. Përveç kësaj kam një shqetësim tjetër, sepse nuk mendoj se ky është problemi, për sa kohë Gjykata Kushtetuese e ka përcaktuar qartë, dhe ka interpretuar nenin e Kushtetutës. Shkruani çfarë të doni në Rregullore, për sa kohë Gjykata Kushtetuese është shprehur se ky është interpretimi i nenit të Kushtetutës dhe asnjë tjetër nuk del mbi të. Pra, do të zbatohet pa diskutim që të jenë 71 deputetë kur fillon mbledhja. Nuk ka rëndësi nëse votojnë apo jo në atë moment. Unë kam një problem tjetër me këtë nen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të mbaroj fjalën për propozimet! Si jeni kaq të paduruar?! Kanë lidhje me njëri-tjetrin.

“Aktet e Kuvendit konsiderohen të miratuara”, pika 3, zonja Pano “kur për to kanë votuar pro shumica e deputetëve”. Çfarë formulimi është ky? Cilët deputetë, ata që janë të pranishëm apo të të gjithë Kuvendit? Duhet të sqarohet, sepse do të bëhemi lëmsh në praktikë. Për mua duhet të jetë ky formulim: “Aktet e Kuvendit konsiderohen të miratuara kur për to kanë votuar pro shumica e deputetëve të pranishëm, përveç rasteve të parashikuara ndryshe në Kushtetutë dhe në ligj”. Dhe do të hiqet pika 5. Ky është formulimi sipas teknikës legjislative dhe sipas atyre që parashikojnë Kushtetuta dhe ligji sot. Pra, kështu duhet të bëhet, sepse në praktikë do të keni probleme dhe do të shkoni përsëri në Gjykatën Kushtetuese.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Po, zoti Fino. Pastaj do të kalojmë në votim.

Bashkim Fino - Pse bëjmë (më falni, që po jua them) rolin e budallait?! Absolutisht, zonja Bushka jam dakord me çfarë thatë ju, sepse nuk mund të dalim mbi Gjykatën Kushtetuese. E the shumë bukur, po e ka kështu Gjykata Kushtetuese nuk dalim dot jashtë saj, por rolin e budallait mos e bëni. Të paktën mos na bëni budallenj ne që e propozuam. Këtu bëhet fjalë për kuorumin për çeljen e seancës së votimit parlamentar, ndërsa unë bëra pyetje tjetër. Nuk fola për kuorumin në momentin e votimit, ai është siç thotë Gjykata Kushtetuese, siç thatë edhe ju, nuk u heq asnjë presje atyre që the, ishe shumë korrekte. Pyetja ime është: kur fillon seanca, siç fillon kryetari i komisionit tonë, a duhet të jetë kuorumi 71 deputetë, kur fillon diskutimi? Kjo nuk ka

lidhje me votimin. Në orën 10:00, po e marr si shembull, nuk ka votim, jam plotësisht dakord, në orën 17:00 ka votim, jam dakord që të jetë pika 2, sepse pa të dhe me atë që ka shprehur Gjykata Kushtetuese ne nuk kemi të drejtë. Unë them, në orën 10:00, a duhet të jenë 71 deputetë që të fillojë seanca? Këtë pyetje bëra.

Ulsi Manja- Faleminderit!

Zonja Mara ka kërkuar fjalën.

Aurora Mara - Zoti kryetar, kam diçka. Nuk duhet të bëjmë gabim, të ngatërrojmë teorinë e prezencës me kuorumin, sepse kjo po ndodh. Në momentin që votojmë në mëngjes në orën 10:00 prezencën, nuk e kemi votuar kuorumin, janë dy teori të ndryshme në ligj. Po të bëjmë këtë gabim, ngatërrojmë të gjithë procesin e Kuvendit dhe shumë gjëra të tjera më vonë.

Ulsi Manja - Shumë e saktë. Zonja Pano, a ka mundësi, se do ta hedh në votim?

Aurora Mara - Më falni!

Ju lutem, të nderuar kolegë, ta mbaroj! Ta qartësojmë këtë ide. Në momentin që do të ngatërrojmë votimin e prezencës në mëngjes me votimin e kuorunit në fund të seancës, ne kemi ngatërruar të gjithë punën e Kuvendit, pasi janë dy teori të ndryshme: prezenca ka një funksion, kuorumi ka një funksion tjetër. Në momentin kur i ngatërrojmë këto dy ide kemi ngatërruar të gjithë punën e Kuvendit.

Ose do të votojmë dy herë, një herë për prezencën në mëngjes dhe një herë për kuorumin. Kanë dy kuptime të ndryshme, ose një herë do të votohet për kuorumin. Interesi është kuorumi në fund.

Ulsi Manja - Dakord. Zonja Pano, a keni ndonjë sugjerim tjetër?

Mimoza Pano – Thjesht dua të orientoj komisionin se jemi duke diskutuar për kreun “Verifikimi i numrit të deputetëve dhe votimi i akteve në seancën plenare”. E kemi kaluar kreun “Për fillimin e seancës plenare”.

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin 32, me formulimin përkatës siç është këtu, me sugjerimet e koleges Bushka dhe me sugjerimet e bëra nga kolegët? Kundër? 1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Shpjegim vote.

Adriatik Alimadhi - Zonja Hysi, ju lutem! Kam një shqetësim, sepse nga momenti që flasim dhe kërkojmë diçka, ju thoni se ky mendim është anarki...

Ulsi Manja – Zoti Alimadhi, ti flet për opinionin publik.

(Zonja Hysi flet pa mikrofon)

Adriatik Alimadhi – Edhe ju nuk keni të drejtë që t’i thoni kolegut: “Ky mendim është anarki”. Pse e shqiptuat këtë gjë? Ju mund të thoni nëse është e drejtë apo gabim, por nuk keni të drejtë të thoni anarki.

Ulsi Manja - Kalojmë te neni 33. Ka propozim konkret? Nuk ka. Kush është dakord? Kundër? 1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 34. Ka propozime për këtë nen? Nuk ka. Kush është dakord? Kundër? 1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 35 që ndryshon nenin 60. Ka propozim konkret? Nuk ka. Kush është dakord? Kundër? 1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Për procedurë? Po, zot Alimadhi.

Adriatik Alimadhi – Duhet të keni parasysh një gjë, ne jemi deputetë të rinj, habitem, pse nxitoheni. Ata që kanë qenë në këtë sallë këtu kanë pasur mendime, ne nuk kemi pasur asnjë mendim. Ju nëse doni ta kaloni vetëm me mendimin tuaj, të maxhorancës, atëherë kalojeni! Por mos shpejtoni kaq shumë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja - Faleminderit!

Ju lutem!

Kush e drejton mbledhjen këtu, se po më çudisni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kolegë deputetë, a ka mundësi?

Zoti Alimadhi, po flisni pa mikrofon!

Zoti Fino, një sekondë, të lutem!

Nuk do të pranoj më asnjë lloj diskutimi me përjashtim të propozimeve konkrete për një arsye të thjeshtë: ka 2 vjet që punohet kjo Rregullore, ka 2 muaj që edhe kolegëve deputetë që kanë ardhur, në çdo seancë plenare u kam thënë: “ Ju lutem, bëhuni pjesë e grupit të punës! Jepni propozimet konkrete me shkrim, me *e-mail!*”. Deri tani jemi vetëm te ky variant që po diskutojmë.

Tani vazhdojmë me nenin 35. Kush është dakord? Kundër? 1 kundër. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Neni 36. Ky nen ka të bëjë me kreun IX “Rregulli dhe sjellja në Kuvend”.

Zonja Hysi, edhe për arsye kohe, tani e kam edhe me ty, nuk dua asnjë koment, asnjë sqarim. Deputetët e kanë mbi tavolinë projektin.

Vasilika Hysi - A mund të sqaroj diçka? Ky është kreu më i rëndësishëm që ndryshon. Ka një propozim dhe është një detyrim që e kemi për shkak të miratimit të Kodit të Sjelljes dhe udhëzuesit, janë tri rekomandime të GRECO-s, që me miratimin e këtij kreu e nxjerrin Shqipërinë me rekomandime të përmbushura. Bëhet fjalë për masat disiplinore që mund të jepen dhe organet që do t’i japin.

Para se të fillojmë nen për nen, sa për ta ditur, deri më sot masat disiplinore i jep ose Kryetari i Kuvendit, ose Byroja e Kuvendit. Nuk ka pasur ankimim. Kjo ishte një shkelje e nenit 6 të Konventës për të pasur një proces të rregullt ligjor dhe ankimim ndaj masave disiplinore.

E dyta, Rregullorja që është në fuqi nuk parashikon përshkallëzim të masave ndaj shkeljeve të lehta, të rënda, shumë të rënda. Në këtë kuadër, propozimi i sjellë nga grupi i punës, bazuar në rekomandimet e GRECO-s, i punuar sipas rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it dhe ekspertizës së ODIHR-it, ka tri risi:

E para, të bëjë lidhjen masave disiplinore në Rregullores dhe shkeljeve që parashikohen në Kodin e Sjelljes.

E dyta, të bëjë klasifikimin e shkeljeve, në shkelje të lehta dhe të rënda.

E treta, fut një mekanizëm të ri me dy shkallë, për dhënien e masave disiplinore e për ankimimin, si dhe qartëson kur merret një masë, për cilën shkelje jepet dhe për cilën nuk jepet.

Pse e them këtë? Në Rregulloren aktuale, Kryetari i Kuvendit dhe Byroja kishte të drejtë të jepte të njëjtën masë, pavarësisht shkallës së rëndësës së shkeljeve. Pra, nuk ishte e qartë.

E dyta, çdo deputet dhe çdo deputete ka të drejtë të dëgjohet. Pra, do të ketë një proces të rregullt ligjor në shqyrtimin e ankesës.

E treta, zoti kryetar, çështja që nuk është adresuar, dhe këtu do të doja që, pasi të diskutojmë këto nene, të themi: a do të parashikojmë në Rregullore një nen për rastin kur deputeti nuk deklaron konfliktin e interesit, për rastin kur është i lobuar, për rastin kur nuk deklaron dhurata? Sepse e kemi detyrim një nen të thjeshtë. Mjafton t’i referohemi ligjit “Për konfliktin e interesave”, por duhet ta themi në Rregullore...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Se është bërë një vërejtje...

Ulsi Manja – Gjejini vendin në Rregullore dhe referojuni ligjit!

Vasilika Hysi – Ja, ta them. GRECO dhe ODIHR thonë: I këshillojmë komisionit përkatës në Parlamentin e Shqipërisë, që të bëjë një lidhje midis shkeljeve që parashikohen në Kodin e Sjelljes dhe dispozitës ose masës që do të jepet, dhe ligjit që do të zbatohet në rastin konkret.

Kjo është. Zoti Alimadhi më bëri një pyetje. Tabela që keni përpara tregon riformulimet e bëra.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem!

Të nderuar kolegë, tani me radhë. Pas këtyre sqarimeve, hedhim në votim nenet, me tabelën bashkëngjitur.

Kush është pro nenit 36?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bashkim Fino – Vasilika, ne e kemi te Kodi i Sjelljes atë punën e konfliktit të interesit, dhe është shumë bukur atje.

Vasilika Hysi – E kemi sanksion.

Bashkim Fino – Sanksion. Tani, sanksioni është ky: në qoftë se unë kam një konflikt interesi që s'e kam thënë...

Ulsi Manja – Të lutem! Nuk jemi në votim, zoti Fino!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bashkim Fino – Jo, jo, dakord jam për nenin 36...

Ulsi Manja – Kush është pro nenit 36? Kundër?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mos më ndërhyjni më kur jam në votim, zonja Hysi!

Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 36?

Bashkim Fino – Mund të bëj një pyetje?

Zonja Hysi, jam plotësisht dakord me ty në lidhje me propozimin e bërë nga GRECO. Tani, unë kam konflikt interesi. Në Kodin e Sjelljes e kemi miratuar, e kemi edhe në broshurë në

parlament. Kemi bërë një Kod Sjelljeje shumë të mirë, pavarësisht sa realizohet. Si mund të dënohem unë me dhjetë ditë që më heqin nga parlamenti, për konflikt interesi? Mbyllet këtu?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po ja, kështu thua ti. Atë e kam te Kodi i Sjelljes, dhe mund të dënohem me këtë. Si mund të dënohem?

(Mungesë e shkurtër incizimi)

Ulsi Manja – ... dhe zgjidhet situata. Përse ma shtroni për diskutim këtë pjesë? Gjejeni çelësin ligjor në Rregullore dhe lidheni me Kodin e Sjelljes.

Vasilika Hysi – Këtë sugjerova.

Ulsi Manja – Këtë sugjerove. Kur të arrijmë te neni përkatës, bëj formulimin.

Neni 37. Kush është pro?

Vasilika Hysi – I riformuluar.

Ulsi Manja – I riformuluar pra, siç e bërë shpjegimin në fillim të kreut.

Kush është pro? Kundër? 1 kundër. Asnjë abstenim.

Miratohet!

Kalojmë te neni 38, që ndryshon nenin 64. Kush është pro? Kundër? 1 kundër. Asnjë abstenim.

Miratohet!

Neni 39, që shton nenet 64/1 dhe 64/2.

Kush është pro? Kundër? 1 kundër. Asnjë abstenim.

Miratohet!

Neni 40, që ndryshon nenin 65.

Kush është pro? Kundër? 1 kundër. Asnjë abstenim.

Miratohet!

Neni 41. Shtohen nenet 65/2 dhe 65/3.

Kush është pro? Kundër 1. Asnjë abstenim.

Miratohet!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem!

Neni 42, që ndryshon nenin 66. Kush është pro?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem! Keni propozim?

Edlira Bode – Po.

Ulsi Manja – Na e thuaj propozimin për nenin 42.

Edlira Bode – Nuk flas për mbledhjet e seancave plenare, po për rastet e mbledhjes së komisionit. Te ky nen parashikohet që drejtuesi ose kryetari i komisionit mund të kërkojë ndërprerje në rast se ka prishje të qetësisë e të rregullit gjatë zhvillimit të mbledhjes së komisionit. Sugjeroj që të mund ta kërkojnë pushimin edhe shumica e deputetëve, me votim.

Ulsi Manja – E kërkojnë.

Edlira Bode – Po.

Ulsi Manja – Edhe sot e bëjnë këtë.

Edlira Bode – Nuk është e shkruar. Më ka ndodhur në praktikë: kemi dashur të bëjmë pushim, por drejtuesi i komisionit nuk na e ka lejuar.

Ulsi Manja – Ajo është çështje tjetër, por nëse njëri nga kolegët e mi deputetë propozon pesë minuta pushim...

Edlira Bode – Dhe të tjerët e votojnë.

Ulsi Manja – S'ka nevojë për votim. E vendos kryetari i komisionit të bëhen pesë minuta pushim, gjë që është njerëzore në një mbledhje komisioni.

Edlira Bode – Po kur nuk do kryetari?

Ulsi Manja – Kur nuk do kryetari, dil, bie kuorumi, e aty mbaron filmi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edlira Bode – Po nuk është kështu, pra. Ta shpjegoj pak rastin konkret.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pse të mos jetë e shkruar, që t'i jepet kjo e drejtë shumicës së anëtarëve të komisionit, për të kërkuar pesë minuta pushim?

Ulsi Manja – Doni ta vendosim si detyrim, kur e kërkon një nga...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edlira Bode – Kur nuk do.

Ulsi Manja – Zonja Hysi, te neni 42, në sugjerim të asaj që thotë kolegja Bode, në rast se çdonjëri nga anëtarët e komisionit kërkon pesë minuta pushim, kjo të jetë detyrim për kryetarin, deri në pesë minuta.

Edlira Bode – Për ta hedhur në votë, për ta hedhur në votim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – E hedhim në votë, po.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edlira Bode – Ia vlen, sepse kam një rast shumë konkret. Tani, nuk është nevoja ta diskutojmë këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – E hedhim në votë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem! E vendos komisioni me votë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edlira Bode – Po pra, të vendoset me votë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem! Ka lidhje edhe me seancën plenare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, sepse flet pa mikrofon, zonja Xhina. Kërkohet fjala dhe merret.

Tani, unë tërhiqem nga kjo, sepse flitet për seancën plenare.

Kush është pro nenit 42, siç është? Kundër? Kundër 1. Abstenim s'ka.

Miratohet!

Neni 43, që shton nenet 66/1 dhe 66/2.

Kush është pro? Kundër? Kundër 1. Abstenim asnjë.

Miratohet!

Neni 44, që lidhet me nenin 68 të Rregullores.

Kush është pro? Kundër? Kundër 1. Abstenim asnjë.

Miratohet neni 44!

Kalojmë te neni 45, që ndryshon nenin 69.

Kush është pro? Kundër? Kundër 1. Abstenim asnjë.

Miratohet!

Neni 46, që ndryshon nenin 70.

Kush është pro? Kundër? Kundër 1. Abstenim asnjë.

Miratohet!

Neni 47, që ndryshon nenin 71.

Kush është pro? Kundër? Kundër 1. Abstenim asnjë.

Miratohet!

Kalojmë te neni 48, që ndryshon nenin 75.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ç'rëndësi ka? Është e shkruar aty.

Kush është pro? Kundër?. Abstenim asnjë.

Miratohet!

Neni 49.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bashkim Fino – A do të jemi të sinqertë? Po të jemi të sinqertë me njëri-tjetrin, po ju them se ky njëzetekatërorëshi është kot fare dhe asnjëherë nuk njihen deputetët me një amendament timin...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, ta mbaroj! Asnjëherë nuk njihen me amendamentin tim 24 orë përpara.

Unë mund ta çoj për procedurë, se e ka Rregullorja dhe ai e merr, e fotokopjon, e shpërndan në të gjithë Kuvendin, por të jesh i bindur se asnjëri nuk e ka parasysh atë.

Për mua amendamenti duhet të ruhet, pra të shikohet që deputetët ta kenë mundësinë të bëjnë një amendament në seancë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Alket Hyseni – Ka një sens...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Në seancë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bashkim Fino – Në seancë, e kupton?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Se ky 24-orëshi... Çfarë përfitojmë ne, Vasilika?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Si rregull, duhen 24 orë. Në seancë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bashkim Fino – Dua ta di: çfarë përfitojmë nga ky 24-orëshi, përveçse është thjesht për Rregulloren?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Shumë faleminderit, zoti Fino!

Fjalën e ka kërkuar zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Në përgjigje të pyetjes së zotit Fino, neni 75 ka të bëjë me shqyrtimin nen për nen dhe ideja e amendamentit në pikat 4 dhe 5 është për t'i dhënë...

(Diskutime në sallë)

Ju lutem, kolegë!

Më falni tani, minimumi të dëgjojmë njëri-tjetrin, në mënyrë që të mos bëjmë pastaj pyetje për gjëra që janë të rregulluara!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në pikat 4 dhe 5 nuk synohet të rregullohet afati 24 orësh, i cili ka qenë në Rregullore dhe vazhdon të jetë, por amendamentet, që paraqet Këshilli i Ministrave, që kanë probleme përputhshmërie me legjislacionin e Bashkimit European, duhet të shoqërohen me raportin e vlerësimit të përputhshmërisë. Pra, asnjë ministër nuk mund të ngrihet e të bëjë një ndryshim, pasi ne deputetët duhet të dimë nëse ky ndryshim i propozuar nga një ministër ose një ministre është ose jo në përputhje me direktivat e BE-së. Flasim gjithnjë për ligje që shoqërohen me tabelë përputhshmërie.

E dyta, në pikën 5 përsëri rregullohet se çfarë ndodh nëse paraqitet një amendament. Nëse paraqitet një amendament nga një deputet i Kuvendit të Shqipërisë, kemi një Drejtorin të Përafritimit të Legjislacionit, e cila është e detyruar të bëjë vlerësimin e përputhshmërisë së amendamentit me direktivën respektive të Bashkimit European.

Nëse kryetari i Komisionit të Integritimit, kryetari i Komisionit të Ligjeve ose grupi parlamentar, ose dhjetë deputetë, ose Kryetari i Kuvendit thotë: kërkoj pushim, pezullim të seancës dhe të mblidhet komisioni për ta diskutuar, kjo rregullohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sepse m'u bë një pyetje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bashkim Fino – Së pari, zonja Hysi, ju falënderoj, pasi jeni lodhur shumë! Por, ju lutem, se ne këtu jemi kolegë, jo studentët tuaj: mos na tërhiqni vëmendjen në çdo fjali!

Tani, ne kërkojmë që ta rregullojmë më mirë, jo që t'ju vëmë juve ose veten tonë në siklet!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pyetjen që bëra e kam parimore, ndërkohë që jam plotësisht dakord me atë që thatë ju, sepse ka të bëjë me vlerësimin e përputhshmërisë me legjislacionin europian nga Këshilli i Ministrave.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pyetja ime ishte ndryshe: kur unë ose ti apo kushdo qoftë duam të bëjmë një amendament dhe, për shkaqe teknike, nuk e kapim dot 24-orëshin, zoti kryetar, dhe në seancë mund të bëj një propozim për rregullim të një neni apo të ndonjë gjëje, por duke më vënë përpara Rregulloren, ku më thuhet: pse nuk e ke bërë 24 orë më përpara, dhe nuk më lejon ta bëj, më duket disi absurde. Prandaj pyes: çfarë përfitoj nëse e bëj amendamentin 24 orë më përpara? Asnjëri nuk e lexon, as grupet parlamentare, asnjëri! Ky ishte thelbi i pyetjes. Pra, nuk kam gjë me nenin në fjalë.

Ulsi Manja – Atëherë, kalojmë te neni 49. Kush është pro? Kundër? Një votë kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Vazhdojmë me nenin 50, që ndryshon nenin 87. Kush është pro? Kundër? Një votë kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 51, që shton nenin e ri 87/1. Kush është pro? Kundër? Një votë kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 52, që ndryshon nenin 93. Kush është pro? Kundër? Një votë kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

Zonja Pano, t'i kishit parë ju që keni dy vjet që merreni me këtë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, se komisioni po voton!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Neni 53, që ndryshon nenin 93.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kush është pro me nenin 53? Kundër? Një votë kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 54, që ndryshon nenin 94. Kush është pro? Kundër? Një votë kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 55, që ndryshon 96. Kush është pro? Kundër? Një votë kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 56, që ndryshon nenin 97. Kush është pro? Kundër? Një votë kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 57. Kush është pro? Kundër? Një votë kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 58, që ndryshon nenin 103. Kush është pro? Kundër? Një votë kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 59. Pas nenit 103 shtohet kreu IV me titullin “Kontrolli parlamentar mbi procesin e integritetit në BE” dhe në këtë kre shtohen nenet 103/1, 103/2, 103/3 dhe 103/4 si më poshtë. Kush është pro? Kundër? Një votë kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 59.

Kalojmë te neni 60, që ndryshon nenin 104. Kush është pro? Kundër? Një votë kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 61, që ndryshon nenin 107. Kush është pro? Kundër? Një votë kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 62, që ndryshon nenin 111. Kush është pro? Kundër? Një votë kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 63, që ndryshon nenin 114. Kush është pro? Kundër? Një votë kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 64, që ndryshon nenin 118.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

Këtu është tërhequr formulimi nga propozuesit. Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste e ka tërhequr propozimin për nenin 118.

Fjalën e ka zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Nenet 118 dhe 119 bëjnë fjalë për procedurat që ndiqen në rastet kur kërkohet autorizimi për heqjen e imunitetit të deputetit, që është neni 118, dhe neni 119 flet për procedurën në rastin kur deputeti është i ndaluar ose i arrestuar.

Ka pasur një propozim të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste që synonte përafrimin e përmbajtjes së neneve 118 dhe 119 me Kushtetutën dhe Kodin e Procedurës Penale.

Zoti Balla e ka tërhequr formulimin dhe me tërheqjen e formulimit nga zoti Balla, nenet 118 dhe 119, siç janë në Rregullore, bien ndesh me Kushtetutën. Prandaj do të kërkoja që t'i riformulojmë. Pse e them këtë? Në paragrafin 1 të nenit 118 thuhet se vazhdon ende autorizimi për fillimin e ndjekjes penale, kur kjo me Kushtetutë nuk ekziston më. Pra, deputeti nuk ka më imunitet ndaj ndjekjes penale, ndaj përgjimeve e kështu me radhë.

Në këtë kuadër, neni 118 duhet të riformulohet, pavarësisht se zoti Balla e ka tërhequr nismën. Kështu, do të sugjeroja që nenet 118 dhe 119 t'i shikojmë me qetësi në grup pune të gjithë bashkë, zotërinj kolegë, dhe të kthehemi nesër, sepse nuk është një ndryshim që mund ta bëjmë tani në çast.

Ulsi Manja – Reflektoni Kushtetutën, zonjë, direkt, çfarë problemi ka?!

Vasilika Hysi – Ekzakt pra!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Merreni atë nen të Kushtetutës...

Vasilika Hysi – Atë do të reflektojmë, Kushtetutën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – ...dhe futeni në Rregullore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pse ka filozofi kjo tani?! Tekstin e Kushtetutës e kemi, me *copy-paste*, futeni te neni 118 dhe u zgjidh.

Vasilika Hysi – Ajo është.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Alket Hyseni – Do të kishte qenë mirë të mos kishte hequr dorë grupi, por unë nuk e di pse ka hequr dorë. Ne nuk po bëjmë asgjë tjetër, veçse po e transpozojmë Kushtetutën në Rregullore. Në qoftë se fillon ndonjëri e bën sofizma dhe interpreton kot politikisht, ky është problemi i tij, jo yni, ne duhet të zbatojmë Kushtetutën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kështu që unë mendoj që duhet ta fusim urgjent. Nuk duhet të kemi fobi ne nga...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Transpozohen Kushtetutën me ndonjë rregullim...

Vasilika Hysi – A mund ta lexoj?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem!

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Propozoj të hiqet paragrafi i parë, sepse nuk ka më nevojë për autorizim për fillimin e ndjekjes penale, dhe të lexohet: “Kërkesa dhe dokumentet shoqëruese për dhënien e autorizimit për caktimin e masës së sigurimit të arrestit me burg, arrestit në shtëpi, heqjes së lirisë në çfarëdolloj forme, kontrollit personal ose të banesës i paraqiten Kryetarit të Kuvendit nga prokurori i çështjes.

Kryetari ia dërgon kërkesën dhe dokumentet shoqëruese menjëherë për shqyrtim Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin dhe vë në dijeni deputetin përkatës.

2. Deputeti, për të cilin kërkohet dhënia e autorizimit, lajmërohet për kërkesën e bërë dhe dokumentet që e shoqërojnë atë, si dhe i bëhet e ditur koha në të cilën Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin do të fillojë shqyrtimin e kërkesës.

Deputeti ka të drejtë të paraqesë në Këshill, me shkrim ose me gojë, shpjegimet dhe vërejtjet e tij.

Në përfundim të shqyrtimit, Këshilli brenda katër javëve (kështu e ka Rregullorja, mund ta bëjmë brenda dy javëve) harton një raport për seancën plenare, në të cilin rekomandohet rrëzimi ose miratimi i dhënies së autorizimit, caktimit të masës së arrestit me burg ose në shtëpi, heqjes së

lirisë në çfarëdolloj forme, kontrollit personal ose të banesës. Raporti i Këshillit u shpërndahej deputetëve”.

Gjithashtu, ka një propozim për pikën 4 që të rishikohet shqyrtimi i kërkesës për caktimin e masës së sigurimit të arrestit me burg ose në shtëpi, heqjes së lirisë në çfarëdolloj forme, kontrollit personal ose të banesës së një deputeti. Vendoset si pikë e parë e rendit të ditës në seancën pasardhëse, pas paraqitjes së raportit në Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin.

Në seancë plenare fjala i jepet në fillim deputetit, ndaj të cilit është paraqitur kërkesa për të dhënë shpjegime ose për t’iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve.

Raporti i Këshillit nuk është objekt diskutimi. Kuvendi vendos me votim të hapur nëse do të jepet ose do të rrëzohet dhënia e autorizimit për caktimin e masës së sigurimit të arrestit me burg ose në shtëpi, heqjes së lirisë në çfarëdolloj forme, kontrollit personal ose të banesës ndaj deputetit”... Kjo ishte sipas Kushtetutës.

Një propozim tjetër është që pika 5 me këtë përmbajtje: “Procedura e parashikuar në pikat 1, 2, 3 dhe 4 zbatohet në rastin kur kërkohet autorizim për” të hiqet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sepse është parashikuar më lart.

Gjithashtu, propozohet të rishikohet edhe pika 7 dhe lexohet: “Përcaktimet e bëra në këtë nen zbatohen edhe në rastet e dhënies së autorizimit për caktimin e masës së sigurimit të arrestit me burg ose në shtëpi, heqjes së lirisë në çfarëdolloj forme, kontrollit personal ose të banesës së anëtarit të Këshillit të Ministrave”. Kjo është.

(Deputetja Bushka ndërhyrje pa mikrofon.)

Ulsi Manja – Shumë faleminderit, zonja Hysi!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

Po, zonja Bushka, për pyetje.

Klotilda Bushka – Kjo që sapo riformuluar është riformulimi që na sillni si sugjerim?

Vasilika Hysi - Po.

Klotilda Bushka- Sepse për sa kohë është tërhequr propozimi nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste, mendova se ishin ato riformulimet. Stafit sjell këtë riformulim, por unë mendoj se ne duhet të jemi korrektë dhe t’u përmbahemi pikë për pikë dhe germë për germë parashikimeve

të Kushtetutës e të Kodit të Procedurës Penale dhe parashikimet, siç janë atje, t'i transpozojmë direkt në këto dispozita të Rregullores.

Ulsi Manja – Që të jemi korrektë, dua t'ju sqaroj se grupi propozues, ai i Partisë Socialiste, është tërhequr nga ndryshimi i neneve 118 dhe 119, edhe pse këto dy nene nuk janë në harmoni me Kushtetutën. Kemi rënë dakord dhe propozuesit janë tërhequr, edhe për të shmangur çdolloj debati politik dhe, kur të jetë rasti, të aplikohet drejtpërsëdrejti Kushtetuta në hierarkinë e normës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem! Unë po shpreh qëndrimin politik. Për nenet 64 dhe 65 propozuesit janë tërhequr dhe për momentin, për sa kohë nuk jam konsultuar me propozuesit, të cilët janë tërhequr, unë nuk hedh në votim asnjë propozim nga grupi i punës. Kjo është vendimmarrje. Nëse duhen shfuqizuar nenet 118 dhe 119 dhe të aplikohet drejtpërsëdrejti Kushtetuta, apo ngelin kështu siç janë dhe aplikohet direkt Kushtetuta në hierarkinë e normës, kjo është çështje tjetër. Ju lutem, sot nuk dua asnjë lloj debati për këto dy nene.

Zoti Bushati është i pranishëm, në emër të propozuesve, prandaj e kam thirrur.

Vasilika Hysi – Unë nuk e lexova propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste. Grupi Parlamentar e ka tërhequr propozimin, por tërheqja e propozimit nga grupi parlamentar i lë nenet 118 dhe 119 në kundërshtim me Kushtetutën, sepse me ndryshimet e bëra në Kushtetutë ne nuk kemi më imunitet ndaj ndjekjes penale dhe pika 1/1, e cila është shtuar në vitin 2011, të krijon përshtypjen se deputetët kanë imunitet, por ne që nga viti 2012 nuk kemi më imunitet dhe në këtë kuadër unë propozova që, meqenëse është tërhequr propozimi i grupit parlamentar, është krijuar një vakum dhe nenet 118 e 119 kanë nevojë të rishikohen, por nuk mund të fshihen komplet, sepse nuk është thjesht referim në Kushtetutë, por rregullon të gjithë punën e Këshillit të Mandateve, çfarë bën, si vepron, janë procedura, afate, përgatitje raporti, të cilat nuk janë çështje kushtetuese, por janë çështje të Rregullores, që duhet të qëndrojnë në Rregullore dhe duhen përshtatur. Propozimi që bëra në fillim është nëse mundemi që të mblidhemi sot të gjithë siç jemi dhe ta rregullojmë.

Ulsi Manja- Para votimit në tërësi do të ulemi të shohim më me qetësi reflektimin e ndryshimit kushtetues në këto nene dhe, nëse do të biem dakord me riformulimin, do ta fusim.

Kalojmë te neni 66, i cili ndryshon nenin...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe ky nen është pjesë e kësaj pakete.

Kalojmë te neni 67, që ndryshon nenin 120 “Shërbimet e Kuvendit”. Kush është pro? Kundër? Një kundër. Asnjë abstenim.

Miratohet.

Kalojmë te neni 68, i cili ndryshon nenin 121. Kush është pro? Kundër? një kundër. Asnjë abstenim.

Miratohet.

Kalojmë te neni 69, i cili shton një nen të ri, nenin 121/1. Kush është pro? Kundër? Një kundër. Asnjë abstenim.

Miratohet.

Kalojmë te neni 70.

Vasilika Hysi – Neni 70 ka lidhje me nenet 118 dhe 119, përkufizimi i cili do të lihet i hapur.

Ulsi Manja- Dakord. Kalojmë te neni 71, “Dispozita kalimtare”. Edhe kjo do të lihet e hapur.

Kalojmë te neni 72, “Hyrja në fuqi e ligjit”. Edhe kjo do të lihet e hapur.

Vasilika Hysi- Zoti Kryetar, kemi lënë disa nene të hapura dhe me kërkesën tuaj stafi i Kuvendit ka punuar, bazuar në propozimin e zotit Hyseni, për të rregulluar sekretariatet, meqenëse në rregulloren aktuale gjente rregullim vetëm sekretariati për buxhetin. Në dokument keni të riformuluara me radhë të gjitha sekretariatet, duke filluar nga neni 5, ku është shtuar neni 5/1, 5/2 e me radhë, të cilat nuk janë shqyrtuar. Prandaj, ju lutem, t’i shqyrtojmë ato, sepse janë nene të reja, që ...

Ulsi Manja - Te sekretariatet kemi lënë hapur nenin 5...

Vasilika Hysi – Në radhë të parë, kemi lënë hapur nenin për stemën, vulën dhe logon, ku propozimin e ka bërë kolegu Hyseni.

Ulsi Manja – Cili nen është?

Vasilika Hysi – Pra, te neni 1, neni a/2 është riformuluar sipas propozimit të kolegut Hyseni.

Ulsi Manja –Ju lutem zonja Hysi, referojuni nenit 1, ku thuhet: “Të shtohet kreu a/1 me këtë përmbajtje”, sepse është kre i ri dhe këtu kemi lënë të hapur nenin a/2, që është stema, vula dhe logoja e Kuvendit, të cilën e keni dakordësuar. Ta hedhim në votim?

Vasilika Hysi- Po.

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin a/2, që ka të bëjë me nenin 1? Kundër? Një kundër. Asnjë abstenim.

Miratohet.

Nenet a/3 dhe a/4 i kemi votuar.

Vasilika Hysi – Te neni 3 kemi një shqetësim, që sapo e përmendi edhe zoti Alimadhi, i cili lidhet me kërkesat që mund të kenë deputetët për Kryetarin e Kuvendit dhe kryetarët e grupeve parlamentare për të mbajtur një minutë heshtje. Me qëllim që të ketë solemnitete dhe të bëhet sipas rregullave, është sugjeruar që të shtohet një pikë 5, më lejoni ta lexoj: “Kryetari i Kuvendit, në këshillim me kryetarët e grupeve parlamentare, vendos për propozimin e deputetit ose deputetëve për të mbajtur 1 minutë heshtje në seancë plenare në rastin.. (në fakt, shprehja “ngjarje tragjike të ndodhura brenda ose jashtë vendit”) mua nuk më pëlqen dhe kërkoj një sugjerim nga ana juaj për të gjetur një fjalë të përshtatshme, sepse 1 minutë heshtje mbajmë edhe për të përkujtuar, por edhe kur ka fatkeqësi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja- Kryetari i Kuvendit në këshillim me kryetarët e grupeve parlamentare vendos për propozime të deputetëve për të mbajtur 1 minutë heshtje në seancë plenare. Në qoftë se Kryetari i Kuvendit në konsultim me kryetarët e grupeve...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E vendos Kryetari i Kuvendit në konsultim me kryetarët...

Vasilika Hysi – Një minutë heshtje për çfarë?!

Alket Hyseni – Heshtja mbahet vetëm për rastet solemne.

Ulsi Manja – Në qoftë se Kryetari i Kuvendit në konsultim me kryetarët e grupeve... Pse duhet ta kufizojmë solemne?!

Atëherë, riformulimi i pikës 5 është: “Kryetari i Kuvendit në këshillim me kryetarët e grupeve parlamentare vendos për propozime të deputetëve ose deputetëve për të mbajtur 1 minutë heshtje në seancë plenare”. Kush është dakord me propozimin e pikës 5? Kundër? Një kundër. Asnjë abstenim .

Miratohet.

Zonja Hysi, çfarë kemi lënë diçka tjetër për diskutim?

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, bazuar në sugjerimet e kolegëve, konkretisht të kolegut Hyseni, te neni 5 janë rregulluar të gjitha sekretariatet.

Pak më parë unë përmenda masat disiplinore, ku tri masat disiplinore që jep Kryetari i Kuvendit nuk janë të ankimueshme, ndërsa dy të tjerat janë të ankimueshme, ku duhet të ketë patjetër shkallë ankimi. Unë bashkë me grupin e punës kemi sugjeruar që të krijonim një këshill etike, por kolegu Hyseni propozon që nuk është e nevojshme të krijojmë një këshill etike, i cili shqyrton masat disiplinore në shkallë të parë dhe sugjeron që, meqenëse ka një organ që është sekretariati për procedurën dhe imunitete, ky sekretariat të marrë edhe shtojcën, fjalën pas “i etikës”. Pra, si shkallë e parë për trajtimin e masave disiplinore të shërbejë një nga sekretariatet që ekziston në Kuvend, që është sekretari për procedurat, votimet dhe të quhet “i etikës”. Ky është neni 5 që ndryshon nenin 10. Zoti kryetar, ky ndryshimi na afekton ne edhe një ndryshim tjetër që, meqenëse sekretariatet përbëhen nga 3 deputetë, 1 sekretar dhe 2 anëtarë, ku vetëm sekretariati për buxhetin ka 5 deputetë, këtij sekretariati, sekretariati për procedurat, votimin dhe i etikës, t’i japim edhe masat disiplinore dhe të përbëhet nga 5 deputetë nga i cili, 1 të jetë sekretar dhe 4 të jenë deputetë.

Nga ana tjetër, do të ketë edhe një ndikim në Byro, meqenëse pjesë e Byrosë është edhe sekretari, duhet të zgjidhim konfliktin e interesit. Pra, sekretari i Sekretariati për Procedurat, Votimet dhe Etikën merr pjesë në mbledhjen e Byrosë, e paraqet rastin, por nuk ka të drejtë të votojë. Unë këtë e kam pasqyruar te vendimmarrja e Byrosë, te neni që sapo miratua. Kjo duhet të zgjidhet parimisht. Nëse ju jeni dakord.

Ulsi Manja – Është e rëndësishme që ne t’i garantojmë një shkallë ankimi deputetit ndaj të cilit është marrë masa disiplinore. Është një zgjidhje e brendshme, pra do të zgjidhet në dy shkallë brenda Kuvendit dhe është krejt normale, sepse maksimumi i masës disiplinore, që do të merret ndaj deputetit, është 10 ditë.

Tani rrimë te ky formulim për nenin 5?

Kush është dakord me nenin 5, me ndryshimet, që janë propozuar nga kolegu Hyseni?

Urdhëroni, zoti Fino!

Bashkim Fino – Ka diskutuar edhe herën parë, madje gjatë. Jam dakord me të gjitha ato që thotë zoti Hyseni për të gjitha sekretariatet, që kanë të bëjnë me buxhetin. Jam dakord me sekretariatit për procedurat e votimet, me atë për statusin e deputetit, me atë për kërkimin parlamentar, me atë për teknologjinë e informacionit, por me sekretariatit e marrëdhënive me jashtë nuk jam dakord. Ne kemi një drejtori të fortë të marrëdhënive me jashtë. Për të gjitha këto

të tjerat ka mungesa dhe këtu, zoti Alket duhet të vendoset edhe numri i deputetëve. Për shembull, 8 deputetët e buxhetit i ke si numër, ndërsa në sekretariatet e tjera nuk e ke vendosur numrin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, pra duhet vendosur numri i deputetëve. Nuk e di nëse do të jenë 3 apo 5, por mirë është të jenë 5. Pra, si e shikoni ju? Me idenë që të jenë nga pozita dhe opozita. Unë në tërësi jam dakord, por me jep një përgjigje, zoti Alket, për sekretariatit e marrëdhënieve me jashtë, sepse e kam shumë merak. Jam shumë i bindur që i sekretariati për statusin e deputetit do të bëjë diçka. Së fundi, edhe ky për teknologjinë e informacionit do të bëjë diçka, por ai i marrëdhënieve me jashtë, duke pasur një drejtori këtu 15-20 veta, që nuk e di si punojnë dhe se çfarë bëjnë, çfarë do të bëjë?

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Ky qëndrim është mbajtur që në fillim.

Urdhëroni, zoti Hyseni!

Alket Hyseni – Është diskutuar edhe në Byro dhe është menduar që, sidomos në fazën integruese, duhet ta ruajmë. Pastaj ajo ka sens për një periudhë normale...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është ai i procedurave dhe votimeve.

Ulsi Manja – Ju lutem, zoti Hyseni!

Zonja Hysi, ta hedhim në votim nenin 5 me ndryshimet përkatëse?

Kush është dakord? Kundër? 1 kundër. Abstenim? 1 abstenim.

Miratohet.

(Diskutime pa mikrofon)

Për cilin nen zonja Hysi?

Vasilika Hysi – Meqenëse ne miratuam që shkalla e parë do të jetë Sekretariati për Procedurat, Votimet dhe Etikën dhe sekretari bën pjesë në Byro, merakun është që në Byro të mos na krijohet numër çift dhe të bllokohet votimi.

Ulsi Manja – Këtë e zgjidhëm.

(Diskutime pa mikrofon)

Ju lutem, të gjithë jemi juristë dhe nuk e rregullojmë dot në Rregullore që votimi të jetë me numër tek?!

(Diskutime pa mikrofon)

Atë e ka ligji “Për organet kolegjiale”.

Urdhëroni, zonja Bushka!

Klotilda Bushka – Mund të quhet vota e Kryetarit vendimtare, sipas ligjit “Për organet kolegjiale”.

Ulsi Manja – A ka nen tjetër që është lënë hapur?

Urdhëroni!

Vasilika Hysi – Të nderuar kolegë, ne kishim lënë të hapur nenin 25, i cili... *(Diskutime pa mikrofon)*

Më fal!

Adriatik Alimadhi – Te neni 10: “Për krijimin e grupeve parlamentare kërkohet një minimum prej 7 deputetësh. Çdo deputet mund të jetë anëtar i vetëm i një grupi parlamentar”. Jemi dakord.

(Diskutime pa mikrofon)

E kemi diskutuar, por kam kërkuar një mendim ose një zgjidhje, në qoftë se ju doni. Te paragrafi i fundit thuhet: “Çdo deputet ka të drejtë të largohet nga grupi parlamentar. Për këtë ai paraqet një deklaratë me shkrim kryesisë së grupit dhe kryetarit të grupit, i cili njofton në seancën më të parë. Deputeti, që largohet nga grupi parlamentar, mund t’i bashkohet një grupi tjetër parlamentar vetëm pas 6-muajve nga data e largimit nga grupi i mëparshëm”. Pra, nga momenti që ky deputet tërhiqet grupi pushon së ekzistuari. Pra, deputetit ia japin të drejtën që ai pas 6-muajsh të mund të regjistrohet në një grup tjetër, por grupi pushon së ekzistuari.

Për shembull, unë sot jam kryetar i grupit dhe më ikën një anëtar, një deputet dhe nga ky momenti nuk kam më grup. Ne këtij deputeti nuk i japim drejtën që brenda 6 muajve të regjistrohet në një grup tjetër, por ia privojmë të drejtën për të mos marrë pjesë... Unë kam shprehur një mendim që të ekzistojë grupi 6 muaj, jo për interesin tim, por për shkak të procedurave, kemi nisur procedurat, jo këshilltar, jo sekretar...

Ulsi Manja – Zonja Hysi, e kemi kaluar nenin 10?

(Diskutime pa mikrofon)

Adriatik Alimadhi – Nuk e kemi miratuar.

Ulsi Manja – Ju lutem, zonja Hysi, e kemi votuar nenin 10?

Zonja Hysi, ku kemi lënë nen të hapur?

(Diskutime pa mikrofon)

Vasilika Hysi – Ndryshimi që bëme te sekretariatet, automatikisht bën që neni 19, që shton nenin 25/1, të bjerë. Pra, ne nuk krijojmë komision etike, pasi këtë kompetencë ia lamë sekretariatit përkatës.

Ulsi Manja – Me formulimin që u pranua te neni 5, bie neni 19, që ne e kemi votuar? Kush është dakord që neni 19 të hiqet? Kundër? 1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

A ka nen tjetër që është lënë hapur?

(Diskutime pa mikrofon)

Në qoftë se bie nën 7 numri i deputetëve në një grup parlamentar, ai nuk quhet grup.

(Diskutime pa mikrofon)

Zoti Alimadhi, kjo bëhet për t'i disiplinuar, sepse mund të na lëvizin një herë në 3 muaj nga një grup në një grup tjetër, por mund të lëvizin edhe përditë.

Ju lutem, zonja Pano, çfarë ka ngelur hapur?

(Diskutime pa mikrofon)

Këtu do ta mbyllim mbledhjen e komisionit.

(Mungesë regjistrimi)

Nesër do të bëjmë një mbledhje tjetër për të mbyllur nenet, që kemi lënë hapur, por edhe votimin në tërësi. Varianti i projektvendimit të Rregullores së re, me ndryshimet përkatëse, do t'u vijë deputetëve në mënyrë të integruar me të gjitha reflektimet e ndryshimeve përkatëse.

Zoti Alimadhi dhe të gjithë kolegët e tjerë deputetë, që duan të punojnë edhe sot pasdite me Rregulloren, përpara votimit në tërësi për nenet që kanë ngelur hapur, mund të ndalojnë këtu dhe të vazhdojnë punën.

Faleminderit dhe ditë mbarë!

Në orën 13:00 anëtarët e komisionit e hetimor të jenë te salla në katin e katërt.

Mbledhja mbyllet.

MBYLLET MBLEDHJA

